



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr. 2 , datë 12/03/2021

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJITIK”,
SHOQËRISË “ELTEX” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik”, shoqërisë “ELTEX” sh.p.k., me vendndodhje, Njësia Administrative Lenie, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan, sipas këtyre treguesve:

HEC Olben

Vepra e marrjes nr. 1:

- X=529908.59
- Y=4533192.43
- Z=868m.m.n.d

Godina e Centralit:

- $X=528621.25$
- $Y=4533013.45$
- $Z=730\text{m.m.n.d}$
- $Q_{\text{mes}}=0.82\text{m}^3/\text{s}$
- $Q_{\text{llog}}=1.2\text{m}^3/\text{s}$
- $Q_{\text{eko}}=0.06\text{m}^3/\text{s}$
- Fuqia e instaluar $N=1.300\text{ kw}$
- Energjia Vjetore $E=4.818.000\text{ kw/vit.}$

2. Zbatimi i lejes nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit të kontratës për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë me ministrinë përgjegjëse për energjinë, pas të cilit do të bëhet edhe zbardhja e formatit të lejes.

KRYETARI

BAKI BALA

